Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-20108 të datës 16.05.2019 të parashtruar nga Alban Mehmetaj nga fsh. Zallq, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e babait Haxhi Mehmetaj në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-20108 të datës 16.05.2019 të parashtruar nga Alban Mehmetaj për përkrahje me karburant për dërgimin e babit QKUK në Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore dhe i lejohej 100 litra karburant për tre muaj.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë Alban Mehmetaj me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Alban Mehmetaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-20108 të datës 16.05.2019, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i tij. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Haxhiu është i sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e tij për marrjen e terapisë në QKUK në Prishtinë. I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij për në Prishtinë për marrjen e terapisë. Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejnë edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi. Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Alban Mehmetaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-216/019	Data: Datum: 21.05.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 22, paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr.03/L-147 dhe nenin 22, paragrafi 2 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj kërkesën Nr.01-120-17878, të datës 02.05.2019, e parashtruar nga Artan Curraj nga fshati Llukac i Begut, Komuna e Istogu për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së babait (Shaban Curraj), i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-120-17878, të datës 02.05.2019, e parashtruar nga Artan Curraj, Zjarrfikës, në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së babait (Shaban Curraj), dhe i ndahen mjetet financiare në shumën prej 345€ (treqind e katërdhjetë e pesë euro) si ndihmë për familjen e të lartpërmendurit.
2. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere ose mallra dhe shërbime në xhirollogarinë e Artan Curraj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Zyrtari për Buxhet dhe Financa.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Artan Curraj, Udhëheqësi i Personelit, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Zyrtari për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-219/019	Data: Datum: 21.05.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nënparagrafin 1.3 të paragrafit 1 të nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010), bazuar në nenin 12 të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil, shqyrtoi kërkesën Nr 01-016-16926 të datës 25.04.2019 të parashtruar nga Mimoza Kabashi nga Gjurakoci, për lejimin e pushimit të lehonisë, nxjerr:

V E N D I M

1. Mimoza Kabashi, e caktuar në punët dhe detyrat e Drejtorit në Shfmu "Martin Camaj" në Gjurakoc, i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 12 muaj.
2. Pushimi, i cekur në pikën 1 të këtij Vendimi fillon me: 14.05.2019 e deri më: 13.05.2020, e përmendura duhet të lajmërohet në punë me: 14.05.2020
3. Në 6 muajt e parë të pushimit të lehonisë, pra prej (14.05.2019 deri me 13.11.2019) paguhet nga institucioni me kompensim 70% të pagës dhe 3 muajt në vijim prej (14.11.2019 deri me 13.02.2020) paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë si dhe 3 muaj tjerë, pa pagesë mund të merren me kërkesën e nëpunësve civile.

A r s y e t i m

Mimoza Kabashi, e caktuar në punët dhe detyrat, Drejtoresh në Shfmu "Martin Camaj" në Gjurakoc, ka parashtruar kërkesën Nr 01-016-16926, me 25.04.2019 me të cilën ka kërkuar lejimin e pushimit të lehonisë. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 12 muaj.

Në pajtim me nënparagrafin 1.3 të paragrafit 1 të nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010), bazuar në nenin 12 të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil, punëtores i takojnë 9 muaj pushim të lehonisë me pagesë dhe 3 muaj të tjerë pa pagesë të cilat mund t'i shfrytëzojë sipas dëshirës.

Punëtorja ka të drejtë që pushimin e lehonisë të përcaktuar në nënparagrafin 2.2 të paragrafit 2 të nenit 12 të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil të mos e shfrytëzojë, mirëpo është e obliguar që më së voni 15 ditë para përfundimit të pushimit gjashtë muaj të njoftoj: Menaxherin e Personelit, se nuk dëshiron të shfrytëzojë pushimin e përcaktuar në kohëzgjatje prej 3 muajve.

Punëtores gjatë periudhës së pushimit të lehonisë të cekur më lartë, 6 muajt e parë i takojnë 70% e të ardhurave personale që do të paguhet nga Institucioni, ndërsa për 3 muaj tjerë të mbetur, pagesa e pagës prej 50% do të bëhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e që realizohet përmes MPMS.

Për realizimin e pagës përmes MPMS-së punëtorja duhet personalisht t'i drejtohet Entit për Punësim për realizimin e kësaj pagese. Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Momoza Kabashi, Menaxheri i Personelit, Përgjegjësjë për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Komunës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-220/019	Data: Datum: 21.05.2019	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), për caktimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Shfmu-së "Martin Camaj" në Gjurakoc, nxjerr:

V E N D I M

1. CAKTOHET: Nimon Curri, Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Shfmu-së "Martin Camaj" në Gjurakoc nga data 14.05.2019 e deri sa të kthehet Drejtoresha znj.Mimoza Kabashi nga pushimi i lehonisë.
2. Sipas këtij vendimi, detyrat e drejtorit i përmenduri do ti kryej me kompetenca të plota në pajtim me Ligjet në fuqi,deri në kthim të drejtoreshes nga pushimi i lehonisë.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Drejtoria për Arsim.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Nimon Curri, Drejtoria për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


 Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-221/019	Data: Datum: 21.05.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) dhe në bazë të nenit 18, paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.03/L-149 dhe nenin 7, paragrafi 1 dhe 5 i Rregullores Nr.02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me qëllim të intervistimit të kandidatëve që kanë konkurruar në konkursin 02 Nr.82/19 të datës 02.05.2019; dhe në konkursin 02 Nr.83/19 të datës 02.05.2019, nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin 02 Nr.83/19 të datës 02.05.2019, për pozitën: Teknik i Gjuetisë, Pylltarisë dhe Peshkimit, me numër të referencës RN00004773 dhe RN00004774, 2 (dy) ekzekutues, në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe komision caktohen:
 1. **Daut Kabashi**, Udhëheqës i Sektorit të Pylltarisë, Kryesues i Komisionit;
 2. **Xhevat Idri zai**, Zyrtar për Pylltari 2, anëtar;
 3. **Zekije Suta**, Udhëheqës i Sektorit Ligjor, anëtare
 4. **Emina Coković**, Zyrtare për Financa , anëtare;
 5. **Hasan Maxharraj**, Zyrtar i Lartë për Shpëztari, Bletari dhe Peshkatari, anëtar;
2. Komisioni i cekur do të mbajë intervistimin me kandidatët të cilët kanë konkurruar për pozitën: Teknik i Gjuetisë, Pylltarisë dhe Peshkimit, në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, 2 (dy) ekzekutues, në pajtim me procedurën e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me listën e ngushtë të kandidatëve të renditur sipas pikëve të fituara të njoftoj Menaxherin e Personelit për procedim të mëtejshëm.
3. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë, Zyra e Personelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni.

Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohet: Komisioni, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.222/019	Data: 22.05.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 22 paragrafi 2 nenparagrafi 2.2. të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010) dhe nenit 19 të Rregullore Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj kërkesën e Menaxherit të Personelit 02 Nr.103/2019 të datës 22.05.2019, për përfundimin e shërbimit-pensionimit të nëpunësit civil Bajram Metaj me titull të postit: Drejtor i SHFMU "Zymer Zeka" në fsh. Kalijan në Drejtorinë për Arsim, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** Kërkesa e Menaxherit të Personelit 02 Nr.103/2019 të datës 22.05.2019, për kompenzimin e një page mujore të cilën e ka realizuar nëpunësi civil Bajram Metaj me titull të postit: Drejtor i SHFMU "Zymer Zeka" në fsh. Kalijan në Drejtorinë për Arsim, për shkak të pensionimit.
2. Nëpunësit civil të lartpërmendur i përfundon shërbimi me 07.06.2019.
3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1. e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim.
4. Zyrtari Financiar obligohet të bëjë pagesën e një page mujore të realizuar, sipas procedurave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë, pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Menaxheri i Personelit, Zyrtari Financiar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Bajram Metaj, Menaxheri i Personelit, Zyrtari Financiar dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.223/019	Data: 22.05.2019	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 67 pragrafi 1 nënpragrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë për Arsim për kompenzimin në lartësi prej 3(tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Sadik Hasanaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Fizikës në SHFMU "Ndre Mjeda" në Rakosh, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e parashtruar nga Drejtoria për Arsim për kompenzimin në lartësi prej 3(tri)pagave mujore që i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Sadik Hasanaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Fizikës në SHFMU "Ndre Mjeda" në Rakosh.
2. Mësimdhënësit të lartpërmendur i përfundon shërbimi me 08.06.2019.
3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim.
4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime në Drejtorinë për Arsim, obligohet që Sadik Hasanaj, t'ia bëjë pagesën, e 3(tri)pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt te fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Arsim dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Sadik Hasanaj, Drejtoria për Arsim, Zyrtari Financiar për Paga, Meditje dhe kompenzime dhe një kopje mbetet në arkivën e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-224/019	Data: Datum: 22.05.2019	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), me kërkesë të Prokurimit për formim të komisionit për vlerësimin e ofertave për projektet: "Loto 1-Ndërtimi i trotuarit Vrellë-Studenicë; Loto 2-Kubzimi i trotuarit Orroberdë-Lagja Hakaj; Loto 3-Ndërtimi i trotuarit Vrellë-Stupe-Kamenicë", me numër të brendshëm të prokurimit 633-019-027-521 dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për Vlerësimin e ofertave për projektet: "Loto 1-Ndërtimi i trotuarit Vrellë-Studenicë; Loto 2-Kubzimi i trotuarit Orroberdë-Lagja Hakaj; Loto 3-Ndërtimi i trotuarit Vrellë-Stupe-Kamenicë", me numër të brendshëm të prokurimit 633-019-027-521 dhe në komision caktohen:
 1. **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Mjedis dhe Eficiencë, Kryesues i komisionit;
 2. **Naser Nimanaj**, Zyrtar i Lartë për Infrastruktur Rrugore, anëtar; dhe
 3. **Agim Ahmetaj**, Zyratar për Emergjencë, anëtar;
2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterit të paraqitur në dosjen e tenderit për projektet: "Loto 1-Ndërtimi i trotuarit Vrellë-Studenicë; Loto 2-Kubzimi i trotuarit Orroberdë-Lagja Hakaj; Loto 3-Ndërtimi i trotuarit Vrellë-Stupe-Kamenicë", si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit të tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.
3. Vlerësimin e ofertave do të kryej Komisioni mbrenda tri ditëve të punës dhe për punën e kryer do ti raportoj Kryetarit të Komunës.
4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisionit dhe Prokurimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Komisioni, Prokurimi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-225/019	Data: Datum: 22.05.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), bazuar në pikën 9.8 të rregulles të Procedurës për Menaxhimin e Qasjes së Përdoruesve në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK), për caktimin e zyrtarit alternativ-Zyrtar për Pranimin e Mallit, nxjerr:

V E N D I M

1. **EMËROHET:** zyrtar alternativ-Zyrtar për Pranimin e Mallit, **Abedin Neziraj**, me titull të vendit të punës Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm, në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim.
2. I lartpërmenduri do ti ndjek trajnimet në SIMFK në Thesar në Ministrinë Financave si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat të tjera që janë të natyrës së tillë.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Abedin Neziraj.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Abedin Neziraj, dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
Nr.Br. 01-227/019	Data: Datum: 23.05.2019		

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), me kërkesë të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim për caktim të mbikëqyrësit për realizimin e projektit: "Mirëmbajtja e Hapësirave Publike në territorin e komunës së Istogut" me numër të brendshëm prokurimi 633/018/006/221 të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis, nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** mbikëqyrës **Dukaxhin Hoxhaj**, Zyrtar për Regjistrimin e Adresave, në Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mjedis, për realizimin e projektit: "Mirëmbajtja e Hapësirave Publike në territorin e komunës së Istogut" me numër të brendshëm prokurimi 633/018/006/221.
2. I lartpërmenduri do të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të projektit të cekur në pikën 1 të këtij Vendimi sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftoj kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punëve; do të njoftoj Kryetarin rregullisht lidhur me realizimin e punimeve sipas projektit të cekur dhe me vështirësitë eventuale që paraqiten gjatë mbikëqyrjes së punëve, si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat të tjera që janë të natyrës së tillë.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij kujdeset: Mbikëqyrësi i projektit dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Dukaxhin Hoxhaj, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, Prokurimi dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-228/019	Data: Datum: 23.05.2019	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010) Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe në bazë të rekomandimeve të Komisionit përzgjedhës, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** propozimi i Komisionit përzgjedhës për vendin e punës: Inspektor Sanitar në Drejtorinë për Inspeksion.
2. Për Vendin e punës: Inspektor Sanitar, pranohet **Ermiona Ahmetaj**.
3. E lartëpërmendura punës ja fillon pasi të kaloj afati i ankesave.
4. Obligohet Personeli që të zbatoj këtë vendim.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Ermiona Ahmetaj, Personeli, Drejtoria për Inspeksion dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-229/019	Data: Datum: 24.05.2019	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), me kërkesë të Prokurimit për formim të komisionit për vlerësimin e ofertave për projektet: "Transporti i nxënësve dhe mesimdhënësve në realicione të ndryshme", me numër të brendshëm të prokurimit 633-019-032-236 dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për Vlerësimin e ofertave për projektet: "Transporti i nxënësve dhe mesimdhënësve në realicione të ndryshme", me numër të brendshëm të prokurimit" 633-019-032-236 dhe në komision caktohen:
 1. **Sami Ferati**, Udhëheqës i Sektorit për Arsim, Kryesues i komisionit;
 2. **Bedri Hajzeraj**, Udhëheqës i Sektorit për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar; dhe
 3. **Qefsere Ibrahimaj**, Zyrtare e Lartë për Trashëgimi Klulturore dhe Arkiv të Qytetit, anëtare;
2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterit të paraqitur në dosjen e tenderit për projektet: "Transporti i nxënësve dhe mesimdhënësve në realicione të ndryshme", me numër të brendshëm të prokurimit, si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit të tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.
3. Vlerësimin e ofertave do të kryej Komisioni mbrenda tri ditëve të punës dhe për punën e kryer do ti raportoj Kryetarit të Komunës.
4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisionit dhe Prokurimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohet: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-230/019	Data: 24.05.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe paragrafi 5 i nenit 2 të Rregullores MF-Nr.4/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, shqyrtoj kërkesën Nr.01-400-9959 të datës 11.03.2019 të parashtruar nga OJQ "Shoqata e të Verbërve", për përkrahje financiare, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-400-9959 të datës 11.03.2019, të parashtruar nga OJQ "Shoqata e të Verbërve" dhe i ndahen 500.00€ (pesëqind euro) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, për përkrahje financiare për shpenzimet e energjisë elektrike, internetit dhe materialit shpenzues për zyre.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e OJQ "Shoqata e të Verbërve", në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: OJQ "Shoqata e të Verbërve", Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbete në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-231/019	Data: Datum: 27.05.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 paragrafi 3 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në nenin 61 paragrafi 61.4, 61.15 dhe neni 9 paragrafi 9.1 shkronja g). Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik i miratuar me datën 01.11.2016 nga KRPP-ja legjislacion dytësor, me kërkesë të Prokurimit, për caktimin e Menaxherit të kontratës për projektin: "Eleminimi i mbeturainave nga hapsirat publike" Loto 1, me numër të brendshëm 633-019-003-521, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** Menaxher i kontratës, **Enver Rugova**, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim për projektin: "Eleminimi i mbeturainave nga hapsirat publike" Loto 1, me numër të brendshëm 633-019-003-521, të cilin është duke e realizuar operatori "Guri" SH.P.K nga fsh. Vrellë, Komuna e Istogu.
2. I lartpërmenduri do të jetë Menaxher i kontratës të cekur në pikën 1 të këtij Vendimi sipas projekti detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punëve; do të njoftojë Kryetarin rregullisht lidhur me realizimin e punimeve sipas projektit (kontratës) të cekur dhe me vështirësitë eventuale që paraqiten gjatë mbikëqyrjes së punëve, si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që janë të natyrës së tillë.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë nga Menaxheri i kontratës, dhe Prokurimi.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Enver Rugova, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-232/019	Data: Datum: 27.05.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 paragrafi 3 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në nenin 61 paragrafi 61.4, 61.15 dhe neni 9 paragrafi 9.1 shkronja g). Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik i miratuar me datën 01.11.2016 nga KRPP-ja legjislacion dytësor, me kërkesë të Prokurimit, për caktimin e Menaxherit të kontratës për projektin: "Ndërtimi i deponisë në Tuqep" Loto 2, me numër të brendshëm 633-019-003-521, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** Menaxher i kontratës, **Enver Rugova**, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim për projektin: "Ndërtimi i deponisë në Tuqep" Loto 2, me numër të brendshëm 633-019-003-521, të cilin është duke e realizuar operatori "SIB" SH.P.K, Komuna e Istogu.
2. I lartpërmenduri do të jetë Menaxher i kontratës të cekur në pikën 1 të këtij Vendimi sipas projekti detal ekzekuti; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punëve; do të njoftojë Kryetarin rregullisht lidhur me realizimin e punimeve sipas projektit (kontratës) të cekur dhe me vështirësitë eventuale që paraqiten gjatë mbikëqyrjes së punëve, si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që janë të natyrës së tillë.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë nga Menaxheri i kontratës, dhe Prokurimi.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Enver Rugova, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-233/019	Data: Datum: 27.05.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), me kërkesë të Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për caktim të mbikëqyrësit për realizimin e projektit: "Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Suriganë, Cerrcë, Mojstirë dhe Shushicë" Loto 1, me numer të brendshëm prokurimi 633/019/017/521, nxjerr:

V E N D I M

- CAKTOHET:** mbikëqyrës **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Mjedis dhe Efiçencë në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për realizimin e projektit: "Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Suriganë, Cerrcë, Mojstirë dhe Shushicë" Loto 1, me numer të brendshëm prokurimi 633/019/017/521, të cilin është duke e realizuar operatori "Mel Engineering" SH.P.K.
- I lartpërmenduri do të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të projektit të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftoj kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punëve; do të njoftoj Kryetarin rregullisht lidhur me realizimin e punimeve sipas projektit të cekur dhe me vështirësitë eventuale që paraqiten gjatë mbikëqyrjes së punëve, si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që janë të natyrës së tillë.
- Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë nga Mbikqyrësi i projektit dhe Prokurimi.
- Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Naser Gjocaj, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Prokurimi dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-234/019	Data: Datum: 27.05.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), me kërkesë të Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për caktim të mbikëqyrësit për realizimin e projektit: "Ndërtimi i urës në Kërrninë" Loto 2, me numer të brendëshëm prokurimi 633/019/017/ 521, nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** mbikëqyrës **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Mjedis dhe Eficiencë në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për realizimin e projektit: "Ndërtimi i urës në Kërrninë" Loto 2, me numer të brendëshëm prokurimi 633/019/017/ 521, të cilin është duke e realizuar operatori "Blenor" SH.P.K.
2. I lartpërmenduri do të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të projektit të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftoj kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punëve; do të njoftoj Kryetarin rregullisht lidhur me realizimin e punimeve sipas projektit të cekur dhe me vështirësitë eventuale që paraqiten gjatë mbikëqyrjes së punëve, si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që janë të natyrës së tillë.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë nga Mbikqyrësi i projektit dhe Prokurimi.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Naser Gjocaj, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Prokurimi dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-235/019	Data: Datum: 27.05.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.10-553-7474 të datës 21.02.2019 të parashtruar nga Safeta Agrović, nga fsh. Banjë, Komuna e Istogut, për ofrim të ndihmës financiare për shërimin e saj dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.10-553-7474 të datës 21.02.2019 të parashtruar nga Safeta Agrović, për ofrim të ndihmës financiare për shërimin e saj dhe me propozim të Komisionit i ndahen 250.00€ (dyqind e pesëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Safeta Agrović, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Safeta Agrović, ka parashtruar kërkesën Nr.10-553-7474 të datës 21.02.2019, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërimin e saj. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendures dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara në lëndë dhe raportet mjekësore shihet se Safeta është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për shërim, i cili shërim është mjaftë i kushtueshëm. E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake ti blejë barnat për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim është përcaktuar pozicioni për subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim. Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e saj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit do të njoftohen: Safeta Agrović, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
Nr.Br. 01-236/019	Data: Datum: 27.05.2019		

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.10-553-21129 të datës 24.05.2019, të parashtruar nga Elvir Balija, nga fsh. Kovragë, Komuna e Istogut, për ofrim të ndihmës financiare për shërimin e saj dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.10-553-21129 të datës 24.05.2019, të parashtruar nga Elvir Balija, për ofrim të ndihmës financiare për shërimin e tij dhe me propozim të Komisionit i ndahen 250.00€ (dyqind e pesëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Elvir Balija, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Elvir Balija, ka parashtruar kërkesën Nr.10-553-21129 të datës 24.05.2019, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërimin e tij. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara në lëndë dhe raportet mjekësore shihet se Ervini është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për shërim, i cili shërim është mjaftë i kushtueshëm. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake ti blejë barnat për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim është përcaktuar pozicioni për subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim. Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyjn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit do të njoftohen: Elvir Balija, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-238/019	Data: Datum: 27.05.2019	

